



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 772/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.12.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit me Nr.REF-33636-11-10-2017 me objekt: “Rikonstruksioni i Rrugës “Enver Bregu” Fshati Rreth Tapi Njësi Administraive Perondi”, me fond limit limit 30.688.791 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22.12.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kuçovë”.

Ankimues: “Shqiponja-M” sh.p.k
Lagja Drita, Burrel

Autoriteti kontraktor: Bashkia Kuçovë,
Blloku Nr.1 Lagja Tafil Skendo,
Kuçovë

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar nëni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.11.2017 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-33636-11-10-2017 me objekt: “*Rikonstruksioni i Rrugës “Enver Bregu” Fshati Rreth Tapi Njësi Administraive Perondi*”, me fond limit limit 30.688.791 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar ne daten 22.12.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kuçovë.

II.2. Në datën 17.11.2017 operatori ekonomik “Shqiponja-M” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë ngrihen pretendime lidhur me hartimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 25.11.2017 autoriteti kontraktor, nëpërmjet shkresës nr.3702/1 prot., datë 21.11.2017, i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e pranuar pjesërisht ankesën.

II.4. Në datën 04.12.2017 autoriteti kontraktor ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit dhe ka publikuar në SPE ndryshimet nëpërmjet një shtojce.

II.5. Në datën 07.12.2017 operatori ekonomik ankimues “Shqiponja-M” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar pretendimet të cilat nuk u morën parasysh nga autoritetit kontraktor. Gjithashtu ngrihen pretendime edhe për ndryshimet e bëra nëpërmjet shtojcës në SPE.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës si dhe dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese

Arsyeton

III.1. Në datën 13.11.2017 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-33636-11-10-2017 me objekt: “Rikonstruksioni i Rrugës “Enver Bregu” Fshati Rreth Tapi Njësi Administrative Perondi”, me fond limit limit 30.688.791 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22.12.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kuçovë.

III.2. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, si dhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues konstatohet se, në datën 17.11.2017 ka mbërritur në adresën e autoritetit kontraktor, ankesa e operatorit ekonomik “Shqiponja-M” sh.p.k, me anë të të cilit kërkohet modifikimi i dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.3. Ankimuesi pohon se në datën 25.11.2017 ka mbërritur në adresën e tij përgjigja e autoritetit kontraktor, dhënë nëpërmjet shkresës nr. 3702/1 prot., datë 21.11.2017. Sipas kësaj shkrese rezulton se autoriteti kontraktor e ka pranuar pjesërisht ankesën.

III.4. Në datën datën 04.12.2017 autoriteti kontraktor ka pasqyruar në SPE ndryshimin e dokumentave të tenderit si dhe ka njoftuar shtyrjen e datës së zhvillimit të procedurës nga data 05.12.2017 në datën 22.12.2017.

III.5. Në datën 07.12.2017 operatori ekonomik ankimues “Shqiponja-M” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Në ankesë kërkohet modifikimi I kriterëve të cilat janë refuzuar nga autoriteti kontraktor si dhe ngrihen pretendime për disa prej kriterëve të modifikuara nga ky autoritet.

III.6. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1 dhe 1.1 të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, në të cilin është parashikuar:

“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që

nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.7. Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimes pohon se ka marrë përgjigje nga autoriteti kontraktor, në lidhje me ankesën e paraqitur pranë tij, në datë 25.11.2017 për modifikimin e dokumentave të tenderit, me shkresën që mban datën 21.11.2017.

KPP vlerëson të ndalet në sqarimin e momentit të analizimit të situatës përse i përket respektimit të kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimes.

Referuar datës së paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor nga ana e ankimesit (17.11.2017), autoriteti kontraktor brenda 3 ditëve nga paraqitja e ankesës pranë tij duhet të kthente përgjigje, pra referuar datës 17.11.2017 kur është depozituar ankesa pranë autoritetit kontraktor, ky i fundit duhet të shqyrtonte ankesën dhe të nxirrte vendimin brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës.

Nga kjo datë, referuar bazës ligjore si më sipër cituar, operatori ekonomik ankimes, nëse autoriteti kontraktor nuk e shqyrtonte ankesën brenda këtij afati, mund të paraqesë ankesë me shkrim pranë KPP, brenda 10 ditëve duke nisur nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit kohor të shqyrtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

Referuar këtyre përcaktimeve, nisur nga data 17.11.2017 kur ka mbërritur ankesa në autoritetin kontraktor, rezulton se ankimesi ka dështuar ta paraqesë ankesën në lidhje me modifikimin e dokumentave të tenderit, në KPP brenda afateve ligjore të përcaktuara në legjislacionin për prokurimin publik, pasi, për faj të vetë këtij të fundit nuk është paraqitur ankimesi në këtë komision brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Mos respektimi i afatit të sipërcituar nga ana e autoritetit kontraktor nuk cënon në asnjë rast pozitën e operatorëve ekonomikë ankimes, pasi kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar edhe momentin procedural të nisjes së llogaritjes së afateve ligjore për ankim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastet kur autoriteti kontraktor nuk shqyrtonte ankesën brenda afatit të parashikuar nga neni 63 të LPP-së. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se ankimesi i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes pranë këtij komisioni më datë 07.12.2017 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga lex specialis, pasi referuar parashikimeve të sipërcituar, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor dhe përfundon ditën e dhjetë.

III.8. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes pranë K.P.P nuk ka respektuar afatet e ankimesit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, çka rrjedhimisht sjell si pasojë që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimesit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 23, pikë 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimesit.

Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis mbi lëndën*.

III.9. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimesit, ankimi nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shqiponja-M” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-33636-11-10-2017 me objekt: “Rikonstruksioni i Rrugës “Enver Bregu” Fshati Rreth Tapi Njësi Administrative Perondi”, me fond limit limit 30.688.791 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22.12.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kuçovë.
2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1808 Protokoli,
Datë 07.12.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha